

TERMAT E REFERENCËS

PËR PËRZGJEDHJEN E NJË SPECIALISTI PËR KOMUNIKIMIN DHE VIZIBILITETIN E PROJEKTIT

Organizata	Qendra për Aftësi Konkurruese - Center for Competitive Skills (CCS)
Marrëveshja	European Union Contribution Agreement nr. AL/IPA III/IPA2022/02
Pozicioni	Specialist për komunikimin dhe vizibilitetin e projektit
Numri i pozicioneve	1
Vendi i punës	Tiranë, me pjesëmarrje dhe udhëtime në aktivitetet e projektit
Periodha e angazhimit	Nga data e përcaktuar në kontratën individuale deri më 9 tetor 2027
Afati i aplikimit	27 korrik 2026, ora 17:00

1. Konteksti

Qendra për Aftësi Konkurruese (CCS), në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Kontributit të Bashkimit Evropian nr. AL/IPA III/IPA2022/02, në bashkëpunim me UNICEF-in, kërkon të angazhojë një Specialist për Komunikimin dhe Vizibilitetin e Projektit. Pozicioni do të sigurojë komunikimin efektiv të aktiviteteve dhe rezultateve të projektit dhe zbatimin e kërkesave të Bashkimit Evropian, IPA III dhe UNICEF-it për komunikimin dhe vizibilitetin.

2. Qëllimi i pozicionit

Specialisti për Komunikimin dhe Vizibilitetin e Projektit do të planifikojë, koordinojë dhe zbatojë aktivitetet e komunikimit, promovimit dhe vizibilitetit në nivel vendor dhe kombëtar. Ai/ajo do të dokumentojë rezultatet e projektit, do të zhvillojë përmbajtje për audiencat e synuara dhe do të sigurojë që materialet dhe aktivitetet publike të jenë në përputhje me identitetin dhe kërkesat e programit të financuar nga Bashkimi Evropian.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Të hartojë dhe zbatojë planin e komunikimit dhe vizibilitetit të projektit në nivel vendor dhe kombëtar;
- Të sigurojë përputhshmërinë e materialeve dhe aktiviteteve me kërkesat e Bashkimit Evropian, IPA III dhe UNICEF-it;
- Të koordinojë aktivitetet e komunikimit me ekipin e projektit, UNICEF-in dhe strukturat përkatëse të komunikimit;
- Të përgatisë dhe përditësojë kalendarin editorial dhe përmbajtjen për faqen e internetit dhe rrjetet sociale të CCS-së;
- Të përgatisë postime, njoftime, artikuj, histori suksesi, intervista dhe materiale të tjera informuese;
- Të dokumentojë aktivitetet dhe rezultatet përmes fotografive, videove, dëshmime dhe materialeve nga terreni;
- Të koordinojë përgatitjen, dizajnimin, prodhimin dhe shpërndarjen e videove, infografikave, buletineve, prezantimeve dhe materialeve promovuese;
- Të sigurojë përdorimin e saktë të logove, deklaratave të financimit dhe elementeve të tjera të vizibilitetit;
- Të mbështesë komunikimin dhe mbulimin mediatik të trajnimeve, workshop-eve, vizitave studimore dhe eventeve të projektit;
- Të monitorojë performancën e publikimeve dhe fushatave dhe të kontribuojë në raportimin e treguesve të komunikimit;
- Të mirëmbajë arkivën elektronike të materialeve dhe të bashkëpunojë me ekipin e projektit për identifikimin e historive të suksesit;
- Të respektojë kërkesat për mbrojtjen e fëmijëve, përdorimin e fotografive dhe videove, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

- Të kryejë detyra të tjera të lidhura drejtpërdrejt me komunikimin, promovimin dhe vizibilitetin e projektit.

4. Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar

- Diplomë universitare, të paktën në nivelin Bachelor, në komunikim, gazetari, marrëdhënie me publikun, marketing, shkenca sociale, administrim biznesi ose fusha të ngjashme;
- Të paktën 3 vjet përvojë profesionale relevante në komunikim, marrëdhënie me publikun, marketing, menaxhim të rrjeteve sociale ose fusha të ngjashme;
- Përvojë në zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve ose planeve të komunikimit dhe vizibilitetit;
- Përvojë në përgatitjen e përmbajtjes për faqe interneti, rrjete sociale, artikuj, buletine ose materiale promovuese;
- Aftësi shumë të mira të shkrimit, redaktimit, komunikimit dhe përshtatjes së mesazheve për audienca të ndryshme;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Njohuri të mira të paketës Microsoft Office dhe mjeteve digjitale të komunikimit;
- Aftësi organizative, vëmendje ndaj detajeve dhe aftësi për të menaxhuar disa detyra dhe afate njëkohësisht;
- Gatishmëri për pjesëmarrje dhe udhëtime në aktivitetet e projektit;
- Integritet profesional dhe respektim të kërkesave për konfidencialitetin, mbrojtjen e fëmijëve dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Përvoja në projekte të financuara nga Bashkimi Evropian, UNICEF-i ose donatorë të tjerë, si dhe njohja e kërkesave të BE-së për komunikimin dhe vizibilitetin, do të konsiderohen avantazh.

5. Vendi dhe periudha e angazhimit

Pozicioni do të jetë i vendosur pranë Qendrës për Aftësi Konkurruese në Tiranë dhe do të përfshijë pjesëmarrje dhe udhëtime në aktivitetet, shkollat dhe bashkitë e projektit.

Shkollat e parashikuara për t'u përfshirë në projekt ndodhen në bashkitë: **Skrapar, Dibër, Librazhd, Prrenjas, Divjakë, Gjirokastrë, Pogradec, Kukës, Kurbini, Lezhë, Vorë dhe Sarandë.**

Angazhimi do të fillojë në datën e përcaktuar në kontratën individuale dhe do të vazhdojë deri më 9 tetor 2027.

6. Dokumentacioni i aplikimit

- CV e përditësuar;
- Letër motivimi;
- Dokumente mbështetëse që dëshmojnë kualifikimet dhe përvojën profesionale;
- Portofol, lidhje ose shembuj të materialeve të mëparshme të komunikimit, nëse disponohen.

Paraqitja e portofolit ose e shembujve të punës do të konsiderohet avantazh.

7. Mënyra dhe afati i aplikimit

Aplikimet duhet të dërgohen deri më **27 korrik 2026, ora 17:00**, në adresën elektronike info@competitiveskills.org, me subjekt: "Aplikim - Specialist për Komunikimin dhe Vizibilitetin e Projektit".

Aplikimet mund të dorëzohen edhe fizikisht në adresën: Qendra për Aftësi Konkurruese, Rruga "Shyqyri Bërxolli", Pallati Aurora, Kati 7, Ap. 28, Tiranë, Shqipëri.

Aplikimet e paraqitura pas afatit mund të mos merren në konsideratë. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për intervistë.

8. Procesi i përzgjedhjes

Përzgjedhja do të zhvillohet përmes shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit dhe intervistës. Kandidatët do të vlerësohen mbi bazën e arsimit dhe kualifikimeve, përvojës profesionale relevante, aftësive për krijimin dhe menaxhimin e përmbajtjes, njohurive mbi komunikimin dhe vizibilitetin e projekteve, aftësive të komunikimit dhe përshtatshmërisë për detyrën.

Procedura është e hapur për kandidatë të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët do të trajtohen në mënyrë të barabartë, transparente dhe konkurruese.

Vlerësimi do të kryhet mbi bazën e dokumentacionit të aplikimit dhe intervistës, me një total prej 100 pikësh.

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Pikët
A	Vlerësimi i CV-së dhe dokumentacionit	70
1	Arsimi dhe kualifikimet akademike përkatëse	10
2	Eksperiencia profesionale në komunikim, marrëdhënie me publikun, marketing ose menaxhim të rrjeteve sociale	20
3	Eksperiencia në përgatitjen e materialeve të komunikimit, artikujve, historive të suksesit dhe përmbajtjes digjitale	15
4	Eksperiencia në komunikimin dhe vizibilitetin e projekteve të financuara nga BE-ja, UNICEF-i ose donatorë të tjerë	10
5	Eksperiencia në organizimin dhe mbulimin e aktiviteteve, eventeve dhe fushatave të komunikimit	10
6	Njohuritë e gjuhës angleze dhe përdorimi i mjeteve digjitale dhe Microsoft Office	5
B	Intervista	30
7	Kuptimi i rolit dhe i kërkesave për komunikimin dhe vizibilitetin e projektit	10
8	Aftësitë e shkrimit, komunikimit, organizimit dhe krijimit të përmbajtjes	10
9	Aftësitë për zgjidhjen e situatave praktike, bashkëpunimin dhe respektimin e afateve	10
	TOTALI	100

10. Dispozita të tjera

Qendra për Aftësi Konkurruese garanton trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim gjatë procesit të përzgjedhjes. Të dhënat personale dhe dokumentacioni i aplikantëve do të përdoren vetëm për qëllimet e procedurës së përzgjedhjes dhe do të trajtohen në përputhje me kërkesat për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Zhvillimi i procedurës së përzgjedhjes nuk krijon detyrim automatik për lidhjen e kontratës. Kontraktimi do të kryhet në përputhje me kërkesat e projektit, disponueshmërinë e fondeve dhe procedurat e brendshme të CCS-së.

Miraturar me Urdhrin "Për miratimin e termave të referencës dhe caktimin e personit përgjegjës për ndjekjen e procedurës me objekt "specialist për komunikimin dhe vizibilitetin e projektit"', datë 20.07.2026, të Drejtoreshës Ekzekutive të Qendrës për Aftësi Konkurruese.